



Taksë mbi Mekanizëm të Rregullimit të Kufirit të Karbonit (CBAM) e Bashkimit European (BE)



pwc



Çfarë është?

Këtë vit, Këshilli Evropian miratoi propozimin për një Mekanizëm të Rregullimit të Kufirit të Karbonit (Referuar këtu e më poshtë si “CBAM”), duke synuar reduktimin e rrjedhjes së karbonit, si pjesë e paketës ‘Fit for 55’ e Bashkimit Evropian, e cila funksionon paralelisht me sistemin e tregtimit të emetimeve të BE (EU ETS).

Pse tani?

CBAM do të jetë një rregullore e re që krijon stimuj financiarë për prodhuesit jo evropianë për të ulur emetimet, dhe do të shërbejë si stimul për të rishikuar dhe përditësuar legjislacionin ekzistues evropian, për t’u siguruar që politikat e BE janë në një linjë me objektivat klimatike.

Pse është e rëndësishme?


Mospërputhja do të ketë kosto shtesë për bizneset shqiptare që tregtojnë në BE, në sektorët të cilat preken nga paketa ‘Fit for 55’

Cilët sektorë preken nga paketa ‘Fit for 55’?

- energjia;
- hekuri;
- çeliku;
- çimento;
- alumini dhe
- plehrat.

Cili është afati kohor i këtij legjislacioni të ri?

- Periudha e tranzicionit: 2023-2026
- Hyrja e plotë në fuqi: 2026 - në vazhdim



Funksionaliteti i EU CBAM

Do krijohet një regjistër EU CBAM, në të cilin do të regjistrohen të gjitha kompanitë që eksportojnë produkte që emetojnë karbon, pjesë të paketës “Fit for 55”. Tarifa e CBAM do të paguhet duke blerë çertifikata CBAM për sasinë e karbonit të tarifueshëm.

CBAM do të zbatohet për mallrat me origjinë nga vendet jashtë territorit të CBAM (p.sh. Shtetet Anëtare të BE-së, Islanda, Norvegjia, Lihtenshtajni dhe Zvicra, si dhe një numër territoresh të vogla si Büsingen, Heligoland, Livigno, Ceuta, Melilla).

Si do të funksionojë?

Do të zbatohet një sistem raportimi nga viti 2023 për këto produkte, me qëllim lehtësimin e integritetit të këtij mekanizmi dhe për të lehtësuar dialogun me vendet e treta, megjithatë importuesit do të fillojnë të paguajnë financiarisht në vitin 2026.

Duke filluar nga janari 2023, importuesit do të jenë të detyruar të mbledhin dhe të raportojnë sasinë e mallrave të caktuara të importuara, emetimet direkte dhe indirekte të përfshira në këto mallra të importuara dhe çmimin e karbonit që mund të jetë paguar tashmë për të prodhuar këto mallra në vendin e tyre të origjinës. Një informacion i tillë duhet të raportohet për çdo lloj malli, për çdo furnizues dhe për çdo tremujor.

Që nga viti 2025/2026, importuesit do të duhet:

- Të blejnë çertifikata CBAM: çmimi i këtyre çertifikatave do të jetë i barabartë me çmimin e karbonit të vendosur nga ETS e BE-së dhe do të publikohet në baza javore.
- Të verifikojnë emetimet e integruara: të dhënat e mbledhura dhe të llogaritura mbi emetimet e integruara duhet të verifikohen nga një verifikues i akredituar.
- Të paraqesin deklaratën CBAM dhe dorëzojnë çertifikatat CBAM deri më **31 maj të çdo viti**. Çertifikatat CBAM që korrespondojnë me emetimet e integruara të deklaruara, duhet të dorëzohen për vitin paraardhës.



Si mund t'ju asistojë PwC Shqipëri?

Ju lutemi na kontaktoni nëse dëshironi të mësoni më në detaje se si do të funksionojë CBAM dhe si do të ndikojë tek ju në situata të ndryshme. Portofoli ynë i produkteve dhe shërbimeve varion nga analizat e ndikimit deri tek qasjet e mundësuar nga teknologjia për të mbledhur, përpunuar dhe raportuar automatikisht të dhënat e lidhura me CBAM, të furnizuesve tuaj. Së bashku, ne do t'ju informojmë mbi CBAM-in e ardhshëm dhe do të sigurojmë një kalim të lehtë në raportimin efikas të emetimeve të karbonit.

PricewaterhouseCoopers Shqipëri

Rruga "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 22 90 700

Email: al_pwc_albania@pwc.com

Web: www.pwc.com/al